



SHOQËRIA E SIGURIMIT ALBSIG SH.A.

# RAPORTI VJETOR

2 0 1 9



# Përmbajtja

<b>1. Informacioni rreth shoqërisë .....</b>	<b>3</b>
1.1. Misioni, vizioni dhe filozofia e shoqërisë.....	4
1.2. Profili i shoqërisë .....	5
1.3. Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm .....	6
1.4. Struktura qeverisëse.....	7
1.5. Albsig jetë sha.....	9
1.6. Albsig invest .....	10
1.7. Albsig me fushatë sensibilizuese për Sigurimin e banesave. ‘Një hap përpara’ .....	12
<b>2. Treguesit kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2019.....</b>	<b>14</b>
2.1. Zhvillimet kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2019.....	14
2.2. Katastrofa e tërmeteve gjatë vitit 2019 .....	15
2.3. Mbi situatën e lidhur me pandeminë (covid-19) Shkurt 2020.....	20
2.4. Perspektiva e sigurimit në trendet e 2020 .....	20
<b>3. Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2019 .....</b>	<b>23</b>
3.1. Analiza vjetore e shoqërisë Albsig .....	23
3.2. Albsig dhe trajnimet e punonjësve .....	23
3.3. Albsig dhe “Dita e karrierës” në Epoka University .....	26
3.4. Albsig pjesë e eventit “Hidh hapin tënd” .....	26
3.5. Albsig sërisht një mbështetje e madhe, “Dita kombëtare e jetimëve”, .....	27
3.6. Albsig sërisht mbështetëse për një mjedis të pastër .....	27
3.7. Albsig mbështetëse e Qendrës Sociale për familjet në nevojë në Bulqizë. ....	28
3.8. Albsig në mbështetje të shkrimtarëve .....	29
<b>4. Politikat e monitorimit, administrimit dhe kontrollit të rrezikut të shoqërisë .....</b>	<b>30</b>
4.1. Menaxhimi i riskut, strategjia dhe politikat e menaxhimit të riskut .....	31
4.2. Përmbushja e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut .....	32
4.3. Risqet për vitin 2019 .....	33
4.4. Kuadri i Administrimit të Riskut .....	37
4.5. Kuadri i raportimit .....	38
4.6. Kontrollat e brendshme.....	39
4.7. Toleranca dhe kufijtë e rrezikut.....	39
4.8. Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese .....	40
4.9. Aktive në mbulim të provigjoneve teknike .....	41
4.10. Marzhi i aftësisë paguese.....	44
4.11. Skenarët e stress-testeve .....	46
4.12. Vetëvlerësimi i riskut, ORSA .....	47
<b>5. Raporti i Audituesit të Pavarur .....</b>	<b>50</b>
5.1. Pasqyra individuale e pozicionit financiar .....	52
5.2. Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse.....	53
5.3. Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital .....	54
5.4. Pasqyra individuale e flukseve monetare .....	55
5.5. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale.....	56
5.6. Skedulet suplementare .....	57
<b>6. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2018.....</b>	<b>60</b>
6.1. Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm .....	60
6.2. Opinioni i Auditorit të Brendshëm.....	60
<b>7. Objektivat e shoqërisë për vitin 2020.....</b>	<b>61</b>
<b>Tabelat</b>	
Tabela 1: Kërkesat dhe udhëzimet lidhur me riskun .....	33
Tabela 2: Ekspozimi ndaj riskut të i kredisë .....	34
Tabela 3: Informacione shpjeguese shtesë për primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguresit .....	35
Tabela 4: Një analizë sasiore të riskut valutor të shoqërisë më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018. ....	36
Tabela 5: Aktive në mbulim të provigjoneve teknike .....	41
Tabela 6: Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj .....	44
Tabela 7: Marzhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 Dhjetor 2019 .....	45



## 1. Informacioni rreth shoqërisë

Albsig sh.a. (“Shoqëria”) është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me vendndodhje në Shqipëri.

Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas Ligjit Shqiptar nr.7638, Dt. 19 Nëntor 1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 Janar 2004.

Shoqëria operon sipas një liçense të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare (“AMF”), më përpara i njohur si Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve (“AMS”), për tregtimin e policave të përgjithshme të sigurimit sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jo-jetës është marrë më datë 19 qershor 2004, ndërsa liçensa që specifikon klasat e aktiviteteve është lëshuar më datë 10 shtator 2004 nga AMS. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pasurinë, shëndetin, dhe produkte të tjera të sigurimit jo-jetë. Shoqëria ka 25 degë gjithsej në qytetet: Tiranë, Durrës, Dibër, Sarandë, Shkodër, Fier, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Gjirokastër, Berat, Kavajë, Lushnje.

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka patur mesatarisht 186 punonjës dhe drejtues (më 31 dhjetor 2018: 177).

Gjatë vitit 2007 Shoqëria filloi aktivitetin në territorin e Republikës Maqedonse nëpërmjet zotërimit 100% të Albsig A.D. Shkup, i liçensuar për të ofruar 11 klasa të sigurimit të jo-jetës. Më datë 21 nëntor 2017, Shoqëria shiti 90% të aksioneve të filialit tek “XH&XH Teknologjia” shpk me bazë në Shkup (Republika Maqedonse). Më 31 dhjetor 2018 Albsig sha zotëronte 10% të filialit i quajtur “NOVA Insurance AD Skopje”, pasi blerësit e rinj e ndryshuan emrin e filialit pas procedurave të kryera pranë Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve në Maqedoni. Më datë 11 janar 2019 shoqëria ka shitur pjesën e mbetur (10%) të aksioneve.

Gjatë vitit 2019 Shoqëria me vendim të asamblesë nr 01/3 datë 27.06.2019, aprovuar nga AMF me vendim nr 13 datë 13.09.2019 ka krijuar shoqërinë Albsig-Jetë me aktivitet në Shqipëri për produktet e jetës. Shoqëria zotëron 100% të aksioneve.

Shoqëria Albsig sha ka Provigjione teknike të mbuluara me aktive dhe Aftësi paguese mbi nivelin e kërkuar nga ligji. Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2019 është 1,430,320,560 lekë (1.8 milion euro).





## 1.1. Misioni dhe vizioni

### MISIONI

Klienti, prioriteti ynë.  
Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij  
përmes shërbimit, integritetit  
dhe profesionalizmit.

### VIZIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti.  
Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

### FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët  
për të arritur suksesin e përbashkët.

## 1.2 Profili i shoqërisë

Emri i Shoqërisë:	<b>ALBSIG sh.a.</b>
Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës:	<b>Z. Shefqet Kastrati Z. Arben Breshani Znj. Ilda Muçmataj</b>
Drejtor i Përgjithshëm:	<b>Z. Muharrem BARDHOCI</b>
Lokalizimi i zyrave qendrore:	<b>Adresa: Rr. “Barrikadave” Albsig HQ No. 10 - 1001 Tirana, Albania</b>
Data e themelimit:	<b>09 / 01 / 2004</b>
Kapitali themeltar:	<b>879,460,000 lekë</b>
Numri i punonjësve:	<b>186</b>
Aktiviteti	<b>Në cilësinë e siguruesit të (Jo-Jetës)</b>
Tel.	<b>+355 (0) 44502060 +355 (0) 4 22 54 760</b>
Website	<b><a href="http://www.albsig.al">www.albsig.al</a></b>
Kontakt	<b><a href="mailto:info@albsig.al">info@albsig.al</a></b>





## 1.3 Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm

Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm,  
**Z. Muharrem BARDHOCI**

*Më lejoni t'ju falenderoj për interesimin tuaj konstant për ALBSIG. Që nga themelimi në vitin 2004, ALBSIG është ndër të paktat shoqëri që ka ruajtur trendin pozitiv dhe që vit pas viti ka konsoliduar e përforcuar pozitat në treg. Sigurisht, kjo rritje konstante vjen si rezultat i investimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme të Grupit Kastrati.*

*ALBSIG për të katërtin vit rradhazi ka patur trendin më të lartë të rritjes. Aktualisht për vitin 2019 pozicionohemi të dytët në treg dhe kjo sigurisht është tregues i besimit të klientëve. Konkurenca në tregun e sigurimeve është shumë e madhe, megjithatë në vite ne ia kemi dalë të ruajmë dhe forcojmë pozitat tona dhe të shtojmë numrin e klientëve. Ne i kushtojmë rëndësi primare marrëdhënieve me klientët. Ekspertët tanë mundësojnë këshillim financiar të personalizuar për secilin prej tyre, individë apo kompani dhe pikërisht falë kësaj filozofie kemi ndërtuar një marrëdhënie afatgjatë dhe të konsoliduar në vite.*

*Një nga prioritetet e ALBSIG gjatë viteve të fundit ka qenë dhe zgjerimi i rrjetit të pikave të shërbimit dhe aktualisht jemi të kudondodhur në të gjithë territorin e Shqipërisë. Por, krahas zgjerimit dhe modernizimit të shërbimeve tona në çdo pikë shitjeje, po investojmë gjerësisht dhe në përmirësimin e shërbimeve online. Synojmë të ofrojmë zgjidhje më të thjeshta, të cilat do të mund të përdoren lehtësisht nga klientët tanë në çdo kohë, 24 orë në 7 ditë të javës. Kemi investuar dhe do të vazhdojmë të investojmë në implementimin e shërbimeve elektronike dhe prioriteti ynë kryesor është ofrimi i shërbimeve që mundësojnë përfitime të qëndrueshme për klientët tanë; shpejtësi në plotësim të nevojave pa kufizime në kohë, me transparencë dhe procedura të thjeshtuara.*

*Kultura korporative dhe modeli i biznesit që ne aplikojmë si pjesë e Grupit Kastrati, na lejon që të kemi avantazhe të shumta, të tilla si reagimi dhe përshtatja e shpejtë ndaj ndryshimeve në treg dhe gjithashtu na mundëson që të kemi rol kryesor në cilësinë e shërbimeve që u ofrojmë klientëve tanë. Jemi pjesë e një prej grupeve më të mëdhenj dhe më të suksesshëm në Shqipëri dhe rajon dhe rrjedhimisht kjo mundëson më shumë siguri dhe më shumë përfitime për klientët tanë.*

*Duam të jemi zgjedhja e parë e shqiptarëve dhe t'u japim vlerë shërbimeve që ofrojmë. Jemi të përkushtuar për të ruajtur dhe konsoliduar besimin e klientëve tanë. E thënë ndryshe, NE në ALBSIG nuk ofrojmë thjesht produkte dhe shërbime, por kujdesemi në çdo detaj për klientët tanë. Ajo që na diferencon, është pikërisht cilësia e produkteve dhe shërbimeve të ofruara.*

*Faleminderit për mbështetjen e vazhdueshme.*

*Me respekt,*  
**Muharrem Bardhoci**

## 1.4 Qeverisja e Shoqërisë

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Shoqëria ALBSIG sh.a është në pronësi të 4 aksionarëve individual

Z. Shefqet Kastrati  
Z. Lokol Xhaja  
Znj. Frida Mucmata  
Znj. Natasha Dhoqina

### KËSHILLI MBIKËQYRËS I SHOQËRISË

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës  
Z. Shefqet Kastrati  
Z. Arben Breshani  
Znj. Ilda Muçmataj

### KOMITETET

1. Komiteti i Administrimit të Riskut
2. Komiteti i Auditimit

### DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Z. Muharrem Bardhoci

### DEPARTAMENTET / DEGËT

ALBSIG është i organizuar në 7 Departamente.  
ALBSIG ka 25 degë, të vendosura në çdo qytet në Shqipëri.  
Numri i të punësuarve është 186

### KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i paguar i shoqërisë më 31 Dhjetor 2014 është 879,460 mijë Lekë  
Kapitali se bashku me fitimin e mbartur me 1,430,320,560 lekë (1.8 milion euro).

## 1.5 Veprimtari sigurimi jo-jetë, në klasat e sigurimit më poshtë:

Liçenca i jep të drejtën Shoqërisë së Sigurimeve Albsig Sh.a e kryerjes së operacioneve të sigurimit në cilësinë e operatorit të Jo-Jetës sipas grupeve të sigurimit të listuara më poshtë:

---

Grupi nr. 1 “Aksidente”

---

Grupi nr. 2 “Sëmundjet”

---

Grupi nr. 3 “Mjete tokësore” (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)

---

Grupi nr. 4 “Mjete lëvizëse mbi shina”

---

Grupi nr. 5 “Avionët”

---

Grupi nr. 6 “Anijet”

---

Grupi nr. 7 “Mallrat në transport”

---

Grupi nr. 8 “Zjarri dhe forcat e natyrës”

---

Grupi nr. 9 “Dëmtime të tjera të pasurisë”

---

Grupi nr. 10 “Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve”

---

Grupi nr. 11 “Përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve”

---

Grupi nr. 12 “Përgjegjësitë civile nga përdorimi i anijeve”

---

Grupi nr. 13 “Përgjegjësitë civile të përgjithshme”

---

Grupi nr. 15 “Garancitë”

---







## 1.6 ALBSIG JETË sh.a.



Shoqëria Albsig-Jetë.sh.a, me seli në Rugën e Barrikadave, Albsig HQ, Kati 8, Tiranë, është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L92019017V në mbështetje të Vendimit Të bordit te AMF-së nr 171, datë 13.09.2019 për të ushtruar veprimtari sigurimi jetë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”,

### 1.6.1.Misioni

Ofrimi i produkteve inovative në tregun e sigurimeve të jetës, duke përmbushur standartet etike, shoqëruar me përfitime të qëndrueshme për klientët dhe bashkëpunëtorët.

Ofrimi i alternativave të përshtatshme për investitorët, ku çdokush të mund të gjejë mënyrën e duhur të investimit, duke u mbështetur tek:

### 1.6.2. Sigurimi i Jetës për Hua

Polica e Sigurimi të Jetës për Hua është një instrument sigurimi që ofrohet për personat që marrin kredi në bankë. Ky sigurim mbulon rrezikun e vdekjes së personit të siguruar pa asnjë kufizim territorial. Në rast vdekje të të siguruarit ALBSIG Jetë merr përsipër detyrimin e plotë financiar ndaj Bankës / Institucionit kredidhënës për huanë e pashlyer duke krijuar mbrojtje financiare për familjarët apo ortakët e biznesit të të siguruarit. Ky sigurim ofrohet për personat me moshë nga 18 deri 65 vjeç, pacarësisht nëse është apo jo kriter në kontratën e kredisë.

### 1.6.3. Sigurimi i jetës dhe aksidenteve

Sigurimi Jetë dhe aksidente ofron mbrojtje financiare për të siguruarin për çdo dëmtim trupor apo paaftësi të shkaktuar nga mjete të rastit ose nga pakujdesia. Ky sigurim ofrohet për personat me moshë deri 65 vjeç për rreziqet e poshtëshënuara;

- Përfitim monetar në rast paaftësie të përhershme të plotë apo të pjesshme nga Aksidentet.
- Përfitim monetar në rast paaftësie të përkohëshme të plotë apo të pjesshme nga Aksidentet.
- Mbulim të shpenzimeve mjekësore për trajtimin e dëmtimit nga aksidenti.
- Përfitim monetar në rast të humbjes së jetës për shkaqe natyrore apo aksidentale (i pagueshëm në favor të familjarëve apo përfituesit të përcaktuar më parë nga i siguruari).

### 1.6.4 Sigurimi Jetë Shëndet Aksidente

Sigurimi Jetë Shëndet Aksidente garanton mbulimin e shpenzimeve për trajtimin mjekësor si nga sëmundjet ashtu edhe nga aksidentet duke ofruar gjithashtu përfitime në rast të paaftësive apo humbjen e jetës.

Ku sigurim ofron përfitimet e mëposhtme:

- Mbulim të shpenzimeve mjekësore për trajtimin si pacient i shtuar.
- Mbulim të shpenzimeve mjekësore për trajtimin si pacient ditor
- Mbulimin e shpenzimeve të transportit për rastet e urgjencës.
- Përfitim monetar në rast paaftësie të përhershme apo të pjesshme nga Aksidentet.
- Check Up mjekësor
- Përfitim monetar në rast të humbjes së jetës për shkaqe natyrore apo aksidentale (i pagueshëm në favor të familjarëve apo përfituesit të përcaktuar më parë nga i siguruari).



### 1.6.5 Risigurimi

Kapaciteti teknik e financiar i shoqërisë garantohej edhe nga bashkëpunimi me SWISS RE, shoqëria e risigurimeve nr. 1 në botë.

Bashkëpunimi me një partner të qëndrueshëm risiguroes si SWISS Re i garanton Albsig Jetë pozicion parësor në treg për produktin e Jetës për Hua, në aspektin e sigurisë, kapacitetit siguroes pa limit, si dhe dëmshpërblim në kohë rekord, në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

## 1.7 ALBSIG INVEST sh.a.



Albsig Invest Sh.a., Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, është një shoqëri aksionare, me seli në Rrugën e Barrikadave, Albsig HQ, Kati 8, Tiranë. Albsig Invest Sh.a është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 04.10.2019

Albsig Invest Sh.a është licensuar Shoqëria Administruese me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nr. 210, datë 22.11.2019 “Për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit, si dhe për administrimin e asetëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive” (Licensa nr. 5, datë 22.11.2019 pa afat). Me vendimin e mësipërm AMF miratoi edhe Fondin e Pensionit Vullnetar Albsig.

Me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nr. 255, datë 30.12.2019, u miratua Fondi i Investimit Albsig Standard.

### 1.7.1 Misioni

Ofrimi i alternativave të përshtatshme për investitorët, ku çdokush të mund të gjejë mënyrën e duhur të investimit, duke u mbështetur tek:

- Informimi dhe edukimi i investitorëve mbi investimin në fonde pensioni dhe fonde investimi;
- Këshillimi i klientëve dhe orientimi i tyre drejt vendimmarrjes së duhur të investimit;
- Menaxhim cilësor të asetëve me qëllim kthime të kënaqshme nga investimi;
- Qeverisje të mirë të korporatës dhe transparencë maksimale për investitorët;

### 1.7.2 Vizioni

Albsig Invest Sh.a synon dhënien e alternativave më të mira të investimit në tregun e kapitalit në Shqipëri.

### 1.7.3 Fond Pensioni

Fondi Pensionit Vullnetar “Albsig” është një alternativë për të patur të ardhura shtesë përveç pensionit të garantuar shtetëror. Fondi është krijuar për të shmangur problematikat e sistemit shtetëror, ku si rrjedhojë e rritjes së jetëgjatësisë nuk u siguron të ardhura të mjaftueshme një pjese të madhe të popullsisë kur arrijnë moshën e pensionit.

Fondi i adresohet klientëve konservator me tolerancë të ulët rreziku. Fondi do investojë vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aseti me rrezikun më të ulët ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve.

#### 1.7.4 Mënyra e Aderimit në Fondin e Pensionit

*Skema Profesionale:* Në skemën profesionale punëdhënësi dhe punëmarrësi (individ) kontribuojnë së bashku në llogarinë e hapur për punëmarrësin (individin).

*Skema Individuale:* Në skemën individuale vetëm individ (punëmarrësi) kontribuon në masën e dëshiruar.

#### 1.7.5 Fondi i Investimit

Fondi i Investimit ALBSIG STANDARD është një sipërmarrje investimesh kolektive (SIK) me ofertë të hapur publike, i krijuar për një afat të pacaktuar, i licensuar në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe themeluar e drejtuar nga Albsig Invest sh.a.

Fondi do të investojë kryesisht në bono dhe obligacione të Shtetit Shqiptar dhe i adresohet klientëve konservator me një horizont afatmesëm investimi duke ofruar likuiditet të lartë (mundësi e tërheqjeve të shumave në çdo kohë).

Elementet kryesore të politikës së investimit janë:

- Objektivi: Fondi synon maksimizimin e fitimit duke ruajtur principalin dhe likuiditetin;
- Toleranca për rrezik: E ulët;
- Horizonti i Investimit: Afatmesëm.





## 1.8 Albsig me fushatë sensibilizuese për Sigurimin e banesave. ‘Një hap përpara’



Fakti që konsumatorët duan siguri kundrejt rrezikut i bën të jenë edhe një hap përpara ndaj të tjerëve nëse janë pjesë e Albsig.

Në fushatën e sigurimit të banesave u lançua një “sfidë” dhe sensibilizoj konsumatorët që të Sigurohen. Të sigurohesh është një process i mjaftueshëm për të parashikuar dhe limituar dëmet e rreziqeve të paparashikuara në pronat e gjithsecilit prej nesh.

Çdo i siguruar është gjithmonë një hap përpara kundrejt çdo të papriture dhe nuk mjaftohet me faktin për të evituar aksidentet, por ai do të jetë i sigurt në hapat që hedh në jetën e tij. Kjo është një vlerë e cila e diferencon këtë individ. Vlerat që na bashkojnë përmbledhin pikërisht edhe këtë virtyt, të qënurit një hap përpara.

“Një hap përpara” është edhe një nevojë që ka tregu ynë për të qënë sa më afër klientit, sa më afër të resë dhe sa më afër zhvillimit.

*E kush më mirë se një shoqëri sigurimi mund ta bënte këtë fushatë?*

### 1.8.1 Qëllimi i Fushatës

- Duke njohur tregun e sigurimeve në Shqipëri, nëpërmjet kësaj fushate u edukuan konsumatorët në pikëpamjen financiare kundrejt portofolit të tyre dhe rëndësisë së sigurimit të banesave si pjesë e kulturës së sigurimit.
- U ndërgjegjësuam një pjesë e mirë e qytetarëve për rëndësinë e sigurimit.
- U njohën me gamën e produkteve të Albsig dhe u nxitën qytetarët të sigurohen për të qënë një hap përpara ndaj dëmeve dhe riskut.
- U lançua brandi i ALBSIG si një shoqëri lider në fushën e Sigurimit, me aftësi dëmshpërblimi në kohë rekord, për t'i mëshuar besimit për t'u siguruar.

### 1.8.2 Komunikimi me konsumatorët

Në këtë fushatë u përdoren foto, postera, spote TV, radio, fletëpalosje dhe materiale promocionale për të lançuar sloganin “NJË HAP PËRPARA”.

Në moment fushata u kthye në një ftesë duke thenë thjesht “Sigurohu!”.

Ndërkohë u lançua brandi i ALBSIG si një shoqëri lider edhe në fushën e komunikimit, madje përfaqësuese e vlerave të vërteta qytetare.

Hashtagu #njëhappërpara u bë motoja e fushatës, duke krijuar një reaktion zinxhir në rrjete sociale, media dhe tv, duke përfshirë edhe brezin e ri, i cili është klient potencial për shumë nga produktet e sigurimit. Fushata kishte një design unik të ndërtuar me këtë qëllim, ku Albsig u bëri një sensibilizim pozitiv i cili tregoi gjithmonë një prosperitet kundrejt rrezikut dhe individit, madje duke e vënë këtë të fundit një hap përpara në çdo eksperiencë.

### 1.8.3. Targeti i Fushatës

- Nxënësit dhe Studentët
- Familjet e reja
- Prindërit
- Profesionistët
- Biznesi

Të gjitha grupmoshat arrihen të targetizohen nëpërmjet kësaj fushate. Produktet të cilat vihen në pah janë:

1. Sigurimi i Shëndetit nga semundjet
2. Sigurimi i Banesës
3. Sigurimi i Përgjegjësisë Profesionale
4. Sigurimi i Mjeteve Motorrike
5. Sigurimi i Biznesit
6. Sigurimi i Nxenësit dhe Studentit
7. Sigurimi i kontratave dhe ofertave

**ALBSIG**  
FUJESË E KASTRATI GROUP

**NJË HAP PËRPARA**

Siguroni banesën tuaj nga tërmeti **50** Për vetëm € /vit

## 2. Zhvillimet kryesore të aktivitetit të Albsig sh.a, gjatë vitit 2019

### 2.1 Zhvillimet kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2019

Përgjatë periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor 2019:

Aktiviteti i shoqërisë për vitin 2019 vlerësohet pozitiv. Bilanci i shoqërisë rezulton me fitim.

Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2019 çoi në konsolidimin e mëtejshëm të shoqërisë. Albsig Sh.a tashmë përfaqëson një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore.

Aktiviteti ekonomik përgjatë vitit 2019 ka shënuar progres të ndjeshëm. Është rritur prezenca e Albsig sh.a në tregun e sigurimeve.

*Prezenca e shoqërisë Albsig sha në treg është finalizuar gjatë këtij viti me një investim të ri, për ushtrimin e aktivitetit të sigurimit të jetës me shoqërinë **ALBSIG JETË**.*

Asambleja e Aksionarëve e Shoqërisë Albsig Sh.a. në mbledhjen e mbajtur më 27/06/2019 ka vendosur që të bëjë një investim të ri, krijimin e ushtrimit të aktivitetit të Sigurimit të Jetës.

Bazuar në Ligjin nr 52/2014 “Mbi veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” neni 81 pika 3 pika b, nevojitet Fond Garancie prej 370 milionë Lekë, për fillimin e këtij aktiviteti.

Në Pasqyrat Financiare të 6-mujorit të parë të vitit 2019, të dorëzuara pranë AMF, vlera e tyre ka ndryshuar. Konkretisht Asetet në mbulim të Provigjioneve Teknike janë nivelin 123% dhe Raporti mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit 220,912,781 Lekë, sipas nenit të cituar më sipër.

Përvec veprimit të mësipërm, pas mbylljes së Pasqyrave Financiare të 6-mujorit të parë të vitit 2019 ka dhe disa ndryshime tjera, të cilat kanë efekt pozitiv në përmirësim më cilësor të parametrave Financiare të Shoqërisë.

Nga një skenar i simuluar, duke përfshirë të gjithë elementet që përmendëm më sipër, kjo e bërë e gjitha në justifikimin e investimit të planifikuar, parametrat teknike Financiare, mbeten pozitive. Konkretisht Raporti mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit në vlera të përafarta është llogaritur rreth 50 milionë lekë mbi nivelin minimal të kërkuar, ndërsa Asetet në Mbulim të Provigjioneve Teknike rreth 109%.

Normalisht, besojmë që parametrat janë më pozitivë se sa paraqiten më lart, por jemi munduar të jemi konservatorë dhe racionalë të kujdesshëm maksimalisht për të ruajtur nivelin e duhur financiar të Shoqërisë edhe pas përfundimit të procesit të Investimit.

## 2.2 Katastrofa e tërmeteve gjatë vitit 2019

Më 26 Nëntor 2019, Shqipëria u godit nga një tërmet i fortë me madhësi 6.3 richter. Tërmeti shkaktoi dëme të mëdha në 11 bashki, përfshirë dy qytetet më të populluara, të urbanizuara dhe të zhvilluara, Tiranë dhe Durrës.

Gadishulli Ballkanik dhe Evropa Jugore kanë një histori të gjatë të tërmeteve shkatërruese. Njerëzit në rajon janë akoma duke rrëfyer tragjeditë njerëzore dhe humbjet e mëdha ekonomike pas tërmeteve që goditën qytete të ndryshme të rajonit, si Shkupi, Bukureshti dhe Selaniku

Gjatë 50 viteve të fundit, Shqipëria ka pësuar humbje njerëzore, lëndime dhe dëme të mëdha në dy tërmete të mëdha: në vitin 1967 (rrethi Dibër) dhe në 1979 (rrethet Shkoder dhe Lezhë). Intensiteti i tërmetit 2019 nuk duhej të ishte surprizë.

Atëherë, çfarë shkoi keq? A është një vend evropian që përballet me një tranzicion të shpejtë shoqëror dhe ekonomik, përfshirë shfrytëzimin e tokës në një ekonomi me rritje të shpejtë, të gatshëm për të zvogëluar në mënyrë proaktive rreziqet e katastrofës?

Një kod i dizajnit sizmik u miratua në vitin 1989 dhe nuk është aktualizuar që nga ajo kohë. Praktikant e dobëta të ndërtimit, përdorimi i materialeve ndërtimore me cilësi të ulët dhe ndryshimet e menaxhuara joadekuata në ndërtesat ekzistuese rritën ndjeshmërinë strukturore të stoqeve të ndërtesave që ishin më të dëmtuarit. Tërmeti shkaktoi rrëshqitje të dheut dhe shkaktoi ndërprerje të rrugës. Likuidimi ka ndodhur në zonat që tashmë janë njohur si më të prekshmet (nga studimet e zonimit mikro sizmik), duke shkakuar ulje të tokës në afërsi të hoteleve të shembura.

Si rezultat i këtij tërmeti, ka mësim kryesor që duhet të marrim nga kjo përvojë.<sup>1</sup>

*Së pari*, është e nevojshme për të integruar DRR (Disaster Risk Reduction) në strategjitë e zhvillimit dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe qeverive për rrezikun e tërmetit. Pa këtë vetëdije, është e vështirë të shfrytëzoni veprimet kolektive. Si pjesë e qeverisjes së rrezikut duhet të caktojmë role në të gjithë shoqërinë dhe të angazhojmë të gjithë palët e interesuara. Ne kemi nevojë për të përmirësuar kodet sizmike, duke përmirësuar dizajnin sizmik dhe praktikën e ndërtimit. Për më tepër, ne kemi nevojë për të fuqizuar komunitetet në menaxhimin e përdorimit të tokës dhe të integrojmë masat zbutëse në planifikimin urban.



<sup>1</sup> Jadranka Mihaljevic, shefe e Departamentit të Inxhinierisë Tërmetike, Instituti i Hidrometeorologjisë dhe Sizmologjisë së Malit të Zi / Dr. Rrapo Ormeni, Sizmolog (Fizikant) në Departamentin e Sizmologjisë, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGWE) Universiteti Politeknik i Tiranës / Dr. Lilit Gevorgyan, studiues i menaxhimit të rrezikut nga katastrofat në Institutin e Shkencave Gjeologjike të Akademisë Kombëtare të Shkencave të Armenisë





Për kaç shumë familje në Shqipëri ky tërmet u ndje si një jetë e kaluar në pak minuta. Në vazhdim, a jemi bërë më të sigurt, më të mençur dhe të pajisur më mirë për të zvogëluar rrezikun dhe për të shmangur një katastrofë në të ardhmen?

*Varet nga ne.*

### *Faktet e tërmetit të 26 Nëntorit 2019 në Shqipëri*

Vdekje:	51
Lënduar:	më shumë se 913
Popullata e prekur:	202,291
Të zhvendosur:	më shumë se 17,000
Ndërtesat u rrënuan:	1.781
Ndërtesa të dëmtuara rëndë:	3,607



### *2.2.1 Shoqëria Albsig dhe tërmetet e 2019*

Albsig dhe menaxhimi i tërmetit të Shtatorit

Sigurimi i pronës, ndonëse një shërbim, i cili në të shumtën e rasteve shikohet si diçka që ka pak gjasa që të përdoret, garanton siguri të plotë për individët dhe bizneset, sidomos në raste të fatkeqësive natyrore si ajo e 21 Shtatorit. ALBSIG, një nga shoqëritë më të mëdha të sigurimeve në vend i kushton një rëndësi të veçantë asistencës së nevojshme në raste të fatkeqësive natyrore. Vetëm një ditë pas tërmetit, ALBSIG ka ngritur menjëherë 6 grupet e specializuara të punës për t'u ardhur në ndihmë jo vetëm klientëve, por dhe konsumatorëve që kërkojnë informacion të saktë për menaxhimin e situatës së krijuar.

Dëmshpërblimi në kohë dhe kundrejt procedurave të rregullta dhe në favor të klientit, ndonëse një proces i munguar në tregun e sigurimeve, për ALBSIG prej më shumë se tre vitesh vlerësohet si një çështje që ka marrë një zgjidhje të plotë dhe përfundimtare.

Statistikat tregojnë se ky proces ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e kënaqësisë së klientëve, zgjerimin e bazës së klientëve besnikë dhe rritjen e numrit të klientëve për të gjitha kategoritë e produkteve dhe shërbimeve.





Tërmeti i 21 Shtatorit në Albsig u mbyll me 226 raste dëmshme me vlerë totale 680,000 Euro ku vlen për tu theksuar se gjysma e këtyre rasteve është trajtuar me pagesë të menjëherëshme brenda nje periudhe 10 ditore ndërsa pjesa tjetër është mbyllur në varësi të procesit i cili ka zgjatur deri në fund të vitit.

### Albsig i përgatitur për tërmetin e 26 Nëntorit.

Ndryshe nga tërmeti i Shtatorit, Tërmeti i Nëntorit ka gjetur Albsig-un e para përgatitur përballë situatës së krijuar. Menjëherë pas ndodhjes së ngjarjes e cila pati dhe humbje në jetë njerëzish në terren kanë zbritur 12 grupe pune të cilët kanë inspektuar dëmet e ndodhura dhe kanë qënë pranë klienteve fizik dhe bizneseve të dëmtuara.



Grupet e punës kanë bërë të mundur identifikimin e të gjithë klienteve të demtuar nga tërmeti. Grupet e terrenit ishin ata që ju erdhën në ndihmë jo vetëm klientëve të shoqërisë por dhe një pjesë të konsiderueshme të konsumatorëve, duke i orientuara drejt mbylljes së procedurave të kërkuara në bashkëpunim dhe me bankat.

Skema e menaxhimit të tërmetit të Albsig ishte e mirëstudiuar pasi vetëm pas 10-ditë nga ndodhja e ngjarjes nisën dhe dëmshpërblimet për dëmet e vogla, ndërsa pjesa tjetër e pallateve problematike dhe e bizneseve u bënë gradualisht, sipas dakortësimit dhe të vetë klientëve.

Aktualisht në Albsig janë 1315 raste të regjistruara dhe të vlerësuara.

Deri më datën 23.06.2020 janë dëmshpërblyer 1234 dëme me vlerë 7.9 milion euro.

Vlen për tu cilësuar se një pjesë e madhe e klientëve të Albsig janë dëmshpërblyer në të dyja rastet e tërmeteve, ku ky target grup ka përfshirë edhe pronat publike siç janë kopshtet dhe shkollat shtetërore. Skema e menaxhimit të Albsig sh.a. bazohet në teknikat e menjëherëshme dhe efikase të menaxhimit të situatave.

Albsig është shoqëria e parë e sigurimeve në treg e cila zë vendin e parë për gjysmën e parë të këtij viti përse i përket dëmshpërblimeve në kohë rekord dhe kundrejt standarteve të duhura.



### **Përfundime nga Raporti i Auditorit të Jashtëm 2019 në lidhje me tërmetet.**

*Referuar kësaj katastrofe të ngjarjeve të ndodhura gjatë vitit 2019 për dy 2 tërmete kemi si më poshtë:*

I pari në 21.09.2019, me magnitudo 5.6 ballë në Shqipërinë qendrore. Shoqëria pothuajse ka likuiduar këto dëme duke regjistruar RBNS në vlerë 8,670 mijë lekë në 31.12.2019. Tërmeti i dytë ka ndodhur më 26.11.2019 me magnitudë 6.4 ballë, duke u cilësuar si tërmeti më i fortë në 40 vitet e fundit. Deri më 31.12.2019 shoqëria ka paguar 138,551 mijë lekë si dhe ka krijuar provigjone RBNS dhe IBNR në vlerë 867,719 mijë lekë.

Shoqëria Albsig renditet e para në tregun e sigurimeve në Shqipëri përse i përket pagimit të pretendimeve të 2 tërmeteve, duke iu referuar publikimeve nga AMF për periudhën Janar Prill 2020. Për tërmetin e Nëntorit, ka pasur raportime për një numër të vogël edhe në muajin Mars-Prill 2020 dhe një numër i vogël pretendimesh janë pezulluar për shkak të faktit se një pjesë e ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti janë bllokuar nga organet shtetërore dhe ende nuk ka asnjë vendim, disa prej tyre janë institucione publike që janë në riparim dhe disa prej tyre janë ofruar dhe deklarimi i vlerës pritet nga të siguruarit. Shoqëria e bazuar në 2 ngjarjet e Shtatorit dhe Nëntorit 2019 dhe në komunikim të vazhdueshëm me ndërmjetësin e risigurimit ka vlerësuar rritjen e kufirit të kontratës së risigurimit për katastrofat nga 25 milion euro në 30 milion euro. Shoqëria ka bërë një shtesë në kontratën e risigurimit për Pasurinë e vitit 2019 deri më 31 Mars 2020 me të njëjtat terma dhe kushte.



### Çështje gjyqësore per 2019.

Sigurimet përveçse një detyrim ligjor janë një domosdoshmëri për të cilën të gjithë pronarët e automjeteve, të bizneseve duhet të jenë të ndërgjegjshëm. Është një shërbim për të cilin urojmë të mos kenë kurrë nevojë, por informacioni rreth procedurimit të një çështjeje sigurimi nuk dëmton askënd. Albsig është një ndër kompanitë e sigurimit që i vjen në ndihmë çdo klienti me të gjitha procedurat që ju kërkohet në rast dëmi. Sipas informacionit të marrë në treg, rezultojnë se shumica e qytetarëve që pësojnë dëm shëndetësor, apo familjarët të cilët mund të kenë humbur të afërmit e tyre në aksident, nuk ndjekin vetë procedurat që e kanë më të lehtë, por kontaktohen apo kontaktojnë avokatët dhe i besojnë atyre ndjekjen e çështjes. Edhe pse problematike si çështje Albsig është një ndër shoqëritë që edukon dhe orienton klientet e saj që mardhënia për çështje gjyqësore të jetë e drejtpërdrejtë pa ndërmjetësinë e një pale të tretë siç janë avokatët. Albsig është shoqëria që veçohet me numrin më të vogël të çështjeve gjyqësore në treg. Referuar të dhënave të AMF<sup>56</sup> të fillimit të vitit 2019, Albsig disponon numrin më të ulët të dëmeve në procese gjyqësore duke e krahasuar me totalin e çështjeve gjyqësore të të gjitha shoqërive në treg. Konkretisht bazuar në të dhënat e marra nga AMF- Albsig disponon vetëm 4 çështje gjyqësore për vitin 2019. Duke e krahasuar me një vit më parë, ky numër i ulet i çështjeve ka dëshmuar në këtë mënyrë edhe nivelin e lartë të përgjegjshmërisë së shoqërisë në raport me klientët e saj dhe përgjigjen në çdo kohë ndaj nevojave të tyre. Marrëveshja me klientët fizikë dhe biznes ka qenë dhe çelësi kryesor i suksesit i cili ka bërë të mundur që Albsig të ketë numrin më të ulët të çështjeve të dëmeve në procese gjyqësore.

### Albsig pa asnjë ankesë në AMF.

Albsig është ndër të vetmet shoqëri sigurimesh që për vitin 2019 nuk ka asnjë ankesë të depozituar në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Ankesat në AMF janë zakonisht për të gjitha praktikatat e dëmeve të trajtuara nga shoqëritë. Produktet dhe shërbimet cilësore dhe mardhënia korrekte me klientët ka bërë që Albsig për vitin 2019 të jetë e vetmja shoqëri pa asnjë ankesë në asnjë lloj fushe. Dhe ky tregues nxjerr në pah dhe punën korrekte të stafit të Albsig. Ndryshe nga vitet e tjera këtë vit AMF ka startuar me një platformë të re të menaxhimit të ankesave të konsumatorëve edhe online. Nuk ke nevojë të sorollatesh poshtë e lartë në trafikun e kryeqytetit. Mjafton të depozitosh ankesën tënde online pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), pasi kjo e fundit ka pak kohë që ka filluar zbatimin e një regjistri të ri, si një platformë për depozitim të ankesave të konsumatorëve. Platforma online e ankesave të qytetarëve ka krijuar mundësinë për çdo konsumator dhe individ të depozitojë problematikën e tij për veprime dhe detyrime që lindin nga aktiviteti i operatorëve ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në tregjet financiare jobankare, nën mbikëqyrjen e AMF-së. Platforma është një mundësi e re për konsumatorët jo vetëm për të shprehur ankesat e tyre por për të ndjekur hap pas hapi mundësinë për zgjidhje.

### 2.3 Mbi situatën e lidhur me pandeminë (COVID-19) Shkurt 2020

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën dhe problemet e lëshimit të pasqyrave financiare individuale.

Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga shoqëria gjatë vitit 2020.

Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale.



### 2.4. Perspektiva e sigurimit në trendet e 2020

Siguruesit përshtaten të rriten në një ekonomi të paqëndrueshme  
Investim i qëndrueshëm, fitime të qëndrueshme?

Duke qenë se një investim i qëndrueshëm është një fenomen relativisht i fundit, të dhënat historike të disponueshme për të analizuar performancën e saj janë shumë më të kufizuara në krahasim me ato për temat e tjera të investimeve. Në bilanc, provat sugjerojnë ose një ndikim neutral nga të paturit e një portofoli të qëndrueshëm të investimeve, ose një përfitim të moderuar të rregulluar nga rreziku afatgjatë. Dëshmi më bindëse mund të gjenden duke bërë dallimin midis përbërësve individualë të ESG. (Environmental, social, and governance) (Mjedisi, ceshtjet sociale dhe qeverisja)

Dëshmia më e fortë është për ndikimin e qeverisjes në performancën e investimeve. Shumica e menaxherëve të pasurive kanë treguar një angazhim për të futur parimin e qeverisjes në politikat e tyre, pasi një kompani me qeverisje të mirë, një horizont afatgjatë dhe një përgjegjësi e mirë shoqërore e korporatave ka të ngjarë të menaxhohet më mirë dhe të shtojë më shumë vlerë me kalimin e kohës.

Duke qenë se përqëndrimi në faktorët ESG (Environmental, social, and governance) (ESG) kriter është një grup i standarteve përdorur nga investitorët për një pamje dhe shtrirje të investimeve

ESG, është një prirje e fundit, lidhja midis faktorëve mjedisorë dhe social dhe performancës së investimeve është më pak e qartë. Kjo do të thuhet, shkencëtarët e mjedisit, rregullatorët dhe politikanët gjithnjë e më shumë po tregojnë rreziqet reale të lidhura me ndryshimin e klimës, duke sugjeruar që një pikë ndërhyrëse mund të jetë arritur në të cilën kompanitë që menaxhojnë këtë rrezik kanë më shumë të ngjarë të arrijnë një rezultat më të mirë.





#### 2.4.1 Përshtatja me zhvillimet teknologjike në ditët e sotme

Ndërsa shoqëritë e sigurimeve përshtaten me tregjet e pjekurisë dhe trazirat ekonomike, në planin afatgjatë, aftësia e tyre për të integruar teknologjinë, talentin dhe inovacionin e modelit të biznesit në mjediset e trashëgimisë mund të jetë çelësi i suksesit.

*Ku qëndrojnë siguresit ndërsa hyjnë në vitin 2020?*

Industria e sigurimeve mbetet elastike, duke vazhduar të gjenerojë rritje në të gjithë botën dhe duke ruajtur përfitimin e përgjithshëm pavarësisht turbullirave në ekonominë globale.

Vlerësimi të Riskut dhe Solventit të Tyre. Autoriteti i Rregullimit të Kujdesit ka deklaruar gjithashtu se pret që siguresit të modelojnë dhe menaxhojnë rreziqet fizike, kalimtare dhe nga përgjegjësite.

Rreziqet fizike mund të kenë të bëjnë me ekspozimin ndaj ngjarjeve të ndryshimit të klimës ose katastrofave natyrore, dhe rrezikut të mëvonshëm të dëmtimit ose humbjes së pasurive të një siguresi.

Rreziku kalimtar është kur një aktiv vuan një humbje të vlerës, e cila mund të jetë shkaktuar ose nga ndryshimi rregullator ose avancimi teknologjik përçarës.<sup>2</sup>

Shpjegohen çështjen e ekspozimit jo-afirmues ‘të heshtur’ në internet dhe ndahet praktikat e mbrojtjes nga rrezikimi në internet për të ndihmuar shoqëritë e sigurimeve për të adresuar atë

Ne jetojmë në një botë të lidhur dixhitalisht, me procese gjithnjë e më shumë të varura nga sistemet e teknologjisë së informacionit (IT). Kjo po gjeneron mundësi për produkte të reja sigurimesh dhe mbulime që adresojnë rreziqet në internet me të cilat përballen shoqëritë. Sidoqoftë, po ndryshon gjithashtu peizazhi i rreziqeve të klasave ekzistuese të biznesit brenda sigurimit jo të jetës, ku ekziston rreziku i pandarë i humbjes si rezultat i ngjarjeve të IT që nuk mund të përjashtohen në formulimet e politikave.

Grupi Punues i Riskut në Kibernetikë inkurajon shoqëritë të përdorin kornizën e tij aty ku është e dobishme, dhe të ndihmojnë në edukimin e menaxhimit mbi rreziqet që paraqesin rreziqet në internet për biznesin ekzistues. Rreziku dhe administrimi i marrjes në sigurim duhet të angazhohen me menaxhmentin për të përvijuar një strategji të qartë për menaxhimin e këtij rreziku në zhvillim dhe për të përcaktuar oreksin e tyre, duke pasur parasysh mirëkuptimin e tyre. Për më tepër, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit mbi rreziqet në internet në të gjithë tregun do të ndihmojë industrinë të përgatitet për të pashmangshmen.

#### 2.4.2 Nevoja sot e përshtatjes së strukturave, procedurave për marrjen në sigurim

Shoqëritë do të duhet të përshtasin bazën e kornizimit më poshtë për të përshtatur strukturën dhe procedurat e marrjes në sigurim

1. Përcaktoni ekspozimin  
Identifikoni dhe përcaktoni linjat e biznesit për t'u përfshirë në vlerësimin tuaj  
Përcaktoni se cila masë e ekspozimit formon bazën, d.m.th humbjen / nocionin maksimal të mundshëm
2. Matricë regjistrimi  
Kryeni një vlerësim të besimit të formulave  
Konsideroni çdo ndryshim të drejtpërdrejtë me risiguresët  
Konsultohuni me ligjin / pretendimet dhe ekspertët e çështjeve kibernetike kur është e mundur
3. Rishikimi i nivelit të politikave  
Përqëndrohuni në ekspozimet materiale / kulmore  
Konsideroni çdo përqëndrim të industrisë që mund të jetë shqetësuese

<sup>2</sup> Simon Cartagena dhe Jasvir Greñal

4. Rishikimi i nivelit të politikave  
Përqendrohuni në ekspozimet materiale / kulmore  
Konsideroni çdo përqëndrim të industrisë që mund të jetë shqetësuese  
Konsideroni qasjen e mostrës për të siguruar një mbulim të mjaftueshëm
5. Aplikoni matricën ndaj ekspozimit  
Kombinoni ekspozimin me besimin e kontratës  
Aty ku dihet informacioni mbi politikat, përcaktoni ekspozimin  
Kur formulimi i politikave është i panjohur, përdorni metodën e tregut  
Gjeneroni skenarë të qetë dhe të veçantë për të kuptuar ndikimet e mundshme në portofolin tuaj
6. Krijoni paketat e informacionit të menaxhimit  
Komunikoni pasigurinë  
Theksioni përdorimin e formulimeve dhe besimin në ato formulime  
Paraqitni skenarë që përcjellin rrezikun në portofolin tuaj
7. Zhvillimi i strategjisë dhe oreksi i rrezikut  
A keni nevojë për të përmirësuar të dhënat?  
Përditësoni politikat për të adresuar shqetësimet e ekspozimit  
Konsideroni opsionet e zbutjes së rrezikut, si nga brenda ashtu edhe nga transferi i rreziqeve të jashtme  
Konsideroni nëse plotësoni ndonjë kërkesë rregullatore
8. Vendoseni si biznes-si zakonisht  
Shndërroni procesin në cikël të biznesit si zakonisht dhe në rregullimin e rregullt të raportimit drejtimit  
Angazhohuni me departamentin e marrjes në sigurim dhe pretendimet rregullisht  
Ndiqni azhurnimet dhe trendet e tregut për ta mbajtur analizën të rëndësishme

Menaxherët dhe aktuarët e rrezikut duhet të jenë të vetëdijshëm për burimet e ndryshme të rrezikut kibernetik jo-afirmues në një portofol të biznesit për të siguruar që ekspozimet po çmohen siç duhet, si dhe të kapen në mënyrë të duhur në modele të kapitalit dhe çmimeve. Kostot e reputacionit, si dhe rritja e interesit rregullator (nga PRA dhe / ose Lloyd), gjithashtu duhet të merren parasysh.

### 2.4.3 Fushat kryesore me përparësi për tu pas në konsideratë

Shoqëritë mund të presin që rezervimi i mjaftueshmërisë, qeverisja dhe kontrollet të jenë fusha të rëndësishme të fokusit mbikëqyrës.

Shqyrtimet rezervë aktuariale gjetën prova që mund të tregojnë se:

- Paragjykimi në vlerësimin e rezervës, duke përfshirë supozimet e favorshme të zhvillimit kur përvoja e fundit tregon në mënyrë të diskutueshme ndryshe
- Dobësimi i bazës së rezervimit të çështjeve
- Kërkesat e papërshtatshme lejojnë inflacionin
- Përkeqësimi i *humbjes* tërheqëse
- Mungesa e transparencës së gjykimeve dhe supozimeve kryesore në informacionin e menaxhimit (MI).
- Kushtet e marrjes në sigurim kanë qenë sfiduese gjatë viteve të fundit, dhe firmat kanë luftuar për të nxitur rritjen e normës.

Disa prova sugjerojnë se kjo ka çuar në nënvlerësimin e mundshëm të rreziqeve, duke çuar disa shoqëri të luftojnë për të arritur fitimin e marrjes në sigurim.

Një seri shqyrtimesh për menaxhimin e ekspozimit kanë identifikuar një sërë fushash për përmirësim, duke përfshirë edhe mosbesimin në vlerësimet e ekspozimit që janë nxjerrë nga modele komplekse, dhe mungesën e vlerësimit të potencialit për ndryshimin dhe shfaqjen e rreziqeve të katastrofës.

## 3. Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2019

### 3.1 Analiza vjetore e shoqërisë Albsig viti 2018-2019

Fillimi i vitit 2019 ka nisur me analizën e punës së Shoqërisë së Sigurimeve Albsig. Optimiste ka qenë dhe atmosfera pasi trendi i rritjes së aktivitetit të shoqërisë sa vjen e shtohet, sidomos të produkteve vullnetare. Në analizën e punës e cila është tashmë traditë që realizohet çdo vit kanë marrë pjesë drejtues dhe specialist të punësuar në Albsig duke përfshirë këtu gjithë rrjetin e shitjes dhe administrimin.

Krahas punës së të gjithë stafit të kualifikuar nën drejtimin e Z. Muharrem Bardhoci dhe Bordit Drejtues, që rezultoi me një

rritje të konsiderueshme krahasuar më vitin 2018, u diskutua dhe u angazhua për të vazhduar punën me përkushtim në shërbim të klientit. Prioritetet, avantazhet dhe objektivat për vitin 2019. Këto kanë qënë dhe pikat më të përfolura për planin e punës për vitin 2019.

Albsig tashmë është një shoqëri me një emër në tregun e sigurimeve ku prioritet i saj mbetet klienti.



### 3.2 Albsig dhe trajnimet e punonjësve

Albsig dhe trajnimet e brendshme të punonjësve të saj. për një performance sa më të mirë të kultivimit të marrëdhënieve sa më profesionale me klientët dhe me konsumatorin në përgjithësi.

Trajnime të shumta janë zhvilluar gjatë vitit 2019 me disa tematika për të ardhur në ndihmë të gjithë punonjësve për të rritur nga ana profesionale, shtimin e njohurive në lidhje me produktet në treg, përditësimin e tyre si dhe menaxhimin sa më të mirë të marrëdhënieve midis punonjësve, agjentëve me konsumatorin.

Tematika të ndryshme u trajtuan gjatë këtij viti si me poshtë:

#### 3.2.1 “Produktet e sigurimit të Shëndetit”, hapin sesionin e trajnimeve në Albsig.

Trajnim mbi shitjet e produkteve vullnetare me fokus kryesor “Sigurimet e produkteve të Shëndetit”. Ky ka qenë qëllimi kryesor që ka mbledhur në zyrat e Shoqërisë së Sigurimeve Albsig.sh.a punonjësit nga të gjitha degët e shoqërisë nëpër rrethe.

Burimet Njerezore kanë cilësuar tashmë trajnimet, si një ndër faktorët kryesorë për performance dhe rritjen e vazhdueshme në tregun e sigurimeve. Për këtë arsye, Alsig investon dhe i kushton vëmendjen e duhur përzgjedhjes dhe vlerësimit të stafit, duke investuar sistematikisht në trajnimin dhe zhvillimin e punonjësve në të gjitha sektorët.



Portofoli i “Sigurimit të shëndetit” duke qenë një ndër më të kërkuarit e viteve të fundit, shoqëria ka investuar në personel të kualifikuar për të qenë sa më afër dhe me korrekt në shërbimin ndaj klientit.

Tematika e dytë e zhvilluar pason me produktet motorike

### *3.2.2. Trajnimet e punonjësve, vijojnë me produktin motorike vullnetare.*

Trajnimi i Sigurimit Motorik Vullnetar Kasko . Ky ka qënë dhe qëllimi kryesor i trajnimit njohja me risitë e reja sidomos me pajisjen GPS dhe lidhjen e domosdoshme me produktin motorik vullnetar Kasko. Në trajnim morën pjesë më shumë se 40 specialistë të marrjes në sigurim të rinj dhe me përvojë, nga të gjitha Degët e Alsig të shtrira në të gjithë vendin. Qëllimi i këtij sesi trajnimi është shtrirja e shitjes së produkteve në të gjithë rrjetin e Alsig, rritja e volumit të klientëve, si dhe aplikimi në mënyrë korrekte i sistemit të shitjes për këto produkte.

Fokus të rëndësishëm zë dhe zbatimi me korrektësi i procedurave, standarteve, si dhe vlerësimit të riskut gjatë marrjes në sigurim. Në mbështetje të produktit Kasko u prezantua dhe rëndësia e shërbimit GPS i lidhur me Kaskon. Trajnuesit janë vetë drejtuesit dhe specialistët e Drejtorisë së Kaskos dhe GPS pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Alsig.sh.a

Tematika pasuese e trajnimeve lidhet me produktet vullnetare të pronës.

### *3.2.3 Alsig: Një staf i trajnuar një pronë e sigurtë*

Sipari i trajnimeve të të gjithë rrjetit të shitjeve në shoqërinë e sigurimeve Alsig ka startuar dhe me produktet e sigurimit vullnetare të pronës.

Trajnimi mbi produktet e sigurimit vullnetar të pronës, konkretisht “Zjarr” dhe “inxhinierike, CAR/EAR. Këto kanë qënë pikat kryesore të trajnimit të stafit të specialistëve të marrjes në sigurim.

Në trajnim morën pjesë më shumë se 40 drejtues degesh të Alsig në Tiranë dhe nëpër rrethe dhe specialistë të marrjes në





sigurim të rinj dhe me përvojë. Qëllimi i këtij sesi trajnimi ishte shtrirja e shitjes së produkteve të pronës në të gjithë rrjetin e shitjeve të Albsig, rritja e volumit të klientëve, si dhe aplikimi në mënyrë korrekte të tarifimit dhe procedurave sipas manualit dhe standartit të Albsig

### ***3.2.4 Albsig: Trajnim mbi administrimin e kontratave të detyrueshme***

Në ambjentet e zyrave Qëndrore të shoqërisë Albsig u zhvillua trajnimi mbi Administrimin e kontratave të detyrueshme motorrke, Licensimin e Agjenteve dhe problematikat mbi menaxhimin dhe administrimin e kontratave të sigurimit. Në trajnim morën pjesë më shumë se 40 agjentë dhe specialistë të marrjes në sigurim të rinj dhe me përvojë, nga të gjitha Degët e Albsig të shtrira në të gjithë vendin.

Qëllimi i këtij sesi trajnimi është mirëmenaxhimi i administrimit dhe zgjidhja e problematikave të administrimit të produkteve të sigurimit në të gjithë rrjetin e Albsig.

Fokus të rëndësishëm zë dhe zbatimi me korrektësi i procedurave të marrjes në sigurim, standarteve, si dhe vlerësimit të riskut. Në mbështetje të Drejtorise së sigurimit Motorrik të detyrueshëm po prezantohet dhe rëndësia e kuadrit ligjor në lidhje me mbarëvajtjen e licensimit të agjentëve. Trajnuesit janë vetë drejtuesit dhe specialistët e Departamentit të Sigurimi motorrik të Detyrueshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Albsig.sh.a



### ***3.2.5 Albsig: Menaxhim sa më të mirë të dëmeve në kohë reale dhe me profesionalizëm.***

Trajtimi i dëmeve është një komponent i rëndësishëm për sigurimet jo jëtë dhe shoqëria Albsig jep rëndësinë e duhur duke e trajtuar si teme delikate me rëndësinë për të marrë një zgjidhje shumë të shpejtë me klientët.

Trajnimi me temë: “Trajtimi i dëmeve, procedurat, problematikat, administrimi, kërkesat ligjore dhe rregullatore”. Realizimi i këtij sesi trajnimesh ka si qëllim mbarëvajtjen e punës lidhur me dëmet dhe trajtimin e tyre. Fokus të rëndësishëm zë dhe zbatimi me korrektësi i procedurave rregullatore, standarteve, si dhe vlerësimit të riskut. Përveç Departamentit të Dëmeve, në trajnim morën pjesë gjithë Departamentet në Drejtorinë e Përgjithshme si Marrjes në sigurim dhe ato të Menaxhimit, Administrimit dhe ato ndihmëse.

### ***3.2.6 Albsig trajnon stafin për implementimin e të reja në kontratave të sigurimit.***

Trajnimi lidhur me implementimin e disa ndryshimeve në format dhe rubrikat e kontratave të Sigurimit nga Zjarri dhe rreziqet shtesë, Vjedhja, Sigurimit të Mallit në Transport, Sigurimet Inxhinierike, Sigurimet e shëndetit, sipas ndryshimeve në sistemin e shitjes së kontratës së sigurimit. Në trajnim morën pjesë më

shumë se 40 specialistë dhe Drejtues të Departamenteve të Albsig në Tiranë. Qëllimi i këtij sesioni trajnimi është: “Zbatimi i procedurave e standardeve gjatë shitjeve të produkteve përmes sistemeve elektronike”. Zhvillimi i këtij trajnimi kishte si qëllim shtrirjen e shitjes së produkteve të mësipërme në të gjithë rrjetin e shitjeve të Albsig, rritja e volumit të klientëve, si dhe aplikimi në mënyrë korrekte i kontratave të sigurimit më të gjitha standartet e kërkuar.

### 3.3 Albsig dhe “Dita e karrierës” në Epoka University

Në fund të muajit Prill 2019 u zhvillua për të tretin vit radhazi “Dita e karrierës” në Epoka University.

Në këtë panair morën pjesë, më shumë se 45 kompani që operojnë në tregun shqiptar duke u dhënë mundësi të rinjve të krijojnë kontakte dhe kryejnë intervista të shumta për startimin e një karriere me një të ardhme të suksesshme për ta.

Sigurisht pjesë e këtij panairi ishte dhe Shoqëria e Sigurimeve Albsig, që një ndër synimet e saj është të jetë pranë të rinjve duke u dhënë mundësi të reja në fushën e sigurimeve.

Mbi 100 studentë kanë aplikuar për të qënë pjesë e shoqërisë Albsig, por vetëm 10 prej tyre të cilësuar si më të mirët kryen intershipe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ALBSIG



### 3.4 Albsig pjesë e eventit “Hidh hapin tënd”

Albsig promovon Vlera. Janë Vlerat ato që na bashkojnë në ditë të tilla dhe që bëhemi përkrahës dhe promotorë të brezave të rinj studentorë. Ne duam të jemi opsioni kryesor për zgjidhjen e mundësive Tuaja. Mjafton ta përzgjidhni Albsig si partnerin tuaj dhe garancia juaj në cdo hap do të jetë e sigurtë.

Dita e karrierës 2019, event i kryer në disa universitete të Tiranës, është realizuar edhe nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës, më 19 prill 2019.

“Hidh hapin tënd” ishte dhe emëritimi I këtij aktiviteti ku



morën pjesë rreth 50 kompani që operojnë në tregun shqiptar.

Edhe Shoqëria e sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, ishte prezente me standën e saj ku informoi dhe ofroi suportin e saj për të gjithë studentët të cilët, dëshironin që të fillonin një intership apo karrierë në fushën e sigurimeve. Albsig ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë një mbështetëse kryesore për të rinjtë pasi dëshiron që t'ju japi mundësi për të zhvilluar një karrierë sa më të suksesshme.

Në këtë event aplikuan me shumë se 90 studentë, ku 10 më të mirëve iu dha mundësia për të kryer intership pranë zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Albsig sh.a.

### 3.5 Albsig sërisht një mbështetje e madhe në “Dita kombëtare e jetimëve”,

Data 20 Maj njihet ndryshe dhe si “Dita kombëtare e jetimëve”, një ditë kjo mjaft speciale për këta fëmijë dhe të rinj.

Një mori aktivitete të ndryshme të organizuara nga Insituti Kombëtar i Integritimit të Jetimëve Shqiptarë, riktheu në vëmendje të shoqërisë këtë kategori fëmijësh që kanë nevojë për suport dhe mbështetje nga të gjithë ne.

Sot janë 180 fëmijë që janë nën kujdesin e shtetit dhe që kanë nevojë tepër të madhe nga të gjithë institucionet shtetërore dhe private.

Shoqëria e sigurimeve Albsig sh. a, për të dytin vit radhazi është kthyer në një nga mbështetësit kryesorë për jetimët në ditën e tyre. Mbështetës kryesorë i eventit ka qene shoqëria e sigurimeve Albsig, duke dhuruar donacione për të qenë sa më afër me këtë pjesë të shoqërisë.

Albsig ka përkrahur dhe vazhdon ta bëjë për cdo aktivitet të realizuar nga institucionet që edukon dhe integron këta fëmijë në shoqëri.

### 3.6 Albsig për një mjedis të pastër

Viti 2019 shënon edhe vitin e dytë për organizimin e aktiviteteve të Eco Tirana me mbështetje dhe të Bashkisë së Tiranës, në sajë të qëllimit për ndërgjegjësimin e shoqërisë më mirëmbajtjen e mjedisit.

Eventi “Ju Mund” iu dha mundësinë nxënësve të shkollave 9 - vjeçare të Tiranës për të realizuar punime të ndryshme me materiale të riciklueshme.

Albsig ishte një ndër mbështetësit kryesorë për këtë event pasi ka si qëllim të jetë suport kryesor për ato aktivitete që kanë qëllim kryesor mbrojtjen e mjedisit.

Nga ky evenet u ndanë edhe cmime për punimet më të mira nga nxënësit.





### 3.7 Albsig mbështetëse e Qendrës Sociale për familjet në nevojë në Bulqizë.




Albsig mbështet hapjen e Qendrës së parë Sociale në qytetin e Bulqizës. Qendra e parë sociale do të jetë në shërbim të personave me nevoja të ndryshme të kësaj zone. Personat me aftësi ndryshe dhe një pjesë e madhe e kësaj kategorie të popullsisë së zonës do të gjejnë mbështetjen e duhur përmes kësaj qendre. Hapja e qendrës u mundësua falë bashkëpunimit midis shërbimit kombëtar të punësimit dhe shërbimit të mbështetjes sociale në

Bashkinë e Bulqizës më mbështetjen kryesore të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig.sh. a.. Konkretisht shërbimet që ofron kjo Qëndër do të jenë shërbime ndaj grupeve të ndryshme, si fëmijëve me aftësi të ndryshme, familjeve në nevojë dhe në të ardhmen do të shtrijë aktivitetin edhe në shërbime ndaj moshës së tretë dhe veteranëve të luftës.

Ndryshe nga qendrat e tjera të hapura nëpër qytetet e vendit kjo e Bulqizes do ju ofroj shërbimet dhe produktet e kërkuara për cdo familje në nevojë. Për ata që do të frekuentojnë qendrën sociale një grup prej dymbëdhjetë kursantësh dhe një specialist kuzhine do të gatujnë çdo ditë për fëmijët me aftësi ndryshe, si dhe jo vetëm kaq por një ditë të javës, për familjet apo grupe shoqërore në nevojë, të identifikuar nga Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkia Bulqizë do të shpërndahet ushqim.

Sipas planit aktual, funksionimi i qendrës do të zgjasë deri në fund të muajit Dhjetor të këtij viti. Bashkia Bulqizë falenderon Albsig-un për mbështetjen në këtë nismë dhe u bën thirrje organizatave, bizneseve dhe individëve me potencial të zonës që të kontribuojnë në zhvillimin e kësaj qendre, me qëllim që kjo qendër të ofroj shërbime për një kohë edhe më të gjatë.





### 3.8. Albsig në mbështetje të shkrimtarëve.

#### 3.8.1 Albsig mbështetje financiare për botimin e librit “Një shekull në memorie” të gjeneral Rahman Parllakut.

“Një shekull në memorie”, ky është titulli i librit në kujtim të gjeneral Rahman Parllakut-“Heroit të popullit dhe Nder i kombit” shqiptar, njëherazi dhe kryetar iOBVL-së. “Një legjendë në kufirin e tri kohëve”, në 100-vjetorin e gjeneralit”. Me rastin e 100-vjetorit të lindjes, përveç mbështetjes së vecantë që bëri Albsig në kuadër të këtij përvjetori dhe Bashkia e Tiranës ka nderuar gjeneral Rahman Parllakun me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës”, një nga figurat emblematiche të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste. Titulli iu dorëzua nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, i cili e vlerësoi gjeneral Parllakun si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Botimi i librit është mbështetur nga ana financiare prej Shoqërisë së Sigurimeve Albsig, e cila ka vlerësuar dhe vlerëson gjithmonë figurat simbolike të kombit shqiptar. Është bërë tashmë traditë që

Albsig mbështet organizatën e bashkuar të veteraneve të shqipërisë me nismat e ndërmarra në nder të gjeneral Parllakut. Aktualisht Albsig ka mbështetur librin voluminoz në të cilin është paraqitur më shumë detaje jeta e gjeneralit dhe pasqyrimi i tre kohëve të kaluara nga ana e tij dhe amanetet që ai u lë brezave në vijim. Libri është vlerësuar nga kritikët e kësaj fushe dhe është mirëpritur nga shkrimtarët dhe artëdashësit. Libri është shkruar në kuadër të 100-vjetorit të ditëlindjes së Gjeneral Rahman Parllakut. Gjeneral Rahman Parllaku është një ndër gjeneralët ushtarak që i mbizotëroi të gjitha ndryshimeve që kaloi shteti shqiptar.

#### 3.8.2 Albsig mbështet financiarisht shkrimtaren Bajame Hoxha Celiku.

Albsig mbështet shkrimtarët e rinj. Për disa vite me radhë, Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group është sponsor dhe mbështetës i shkrimtarëve. Shkrimtarët e rinj me veprat e tyre si në fushën e letërsisë ashtu dhe në atë të historisë me përmbajtjen e tyre ndërtojnë një lidhje mes anës shpirtërore dhe asaj reale të njeriut dhe e afirmojnë mendimin kulturor, historik. Motivi kryesor për përfshirjen në këto projekte është që shkrimtarëve të njohur dhe të rinjve me nevoja të veçanta t’iu mundësojë zhvillimin e një frymë të shëndetshme dhe aftësi krijuese, për tu edukuar dhe integruar plotësisht në rrymat letrare që ata përfaqësojnë. Vazhdimi i bashkëpunimit me Shkrimtarët dhe mbështetja e këtyre projekteve konfirmon përpjekjet Albsig për një qasje afatgjatë dhe sistematike për të përmirësuar mirëqenien e grupeve të pambrojtura në komunitet dhe është në përputhje me angazhimet strategjike të Albsig në fushën e përgjegjësisë sociale. Në të gjithë besojmë në një të ardhme më të mirë, por shikimi në të ardhmen nënkupton pranimin e përgjegjësisë për atë që po ndodh sot në shoqëri, për të nxitur ndryshimet, si në sektorin tonë profesional, ashtu edhe në komunitetin në përgjithësi. Qëllimi i çdo shoqërie dhe çdo individi është të jetojë në harmoni me vetveten dhe me mjedisin e tij. Prandaj është e nevojshme të jetë përgjegjës për çdo veprim dhe vendim, profesional dhe personal. Në kuadër të mbështetjes së zhvillimit të mëtejshëm të artit dhe kulturës Albsig thaujse për cdo vit mbështet si sponsor shkrimtarët e rinj. Këtë vit financoi shkrimtaren e njohur znj. Bajame Hoxha Çeliku duke bërë të mundur sponsorizimin e botimit të librit të saj të fundit. Ndër vite Albsig numëron rreth 200 libra të sponsorizuara për botim të shkrimtarëve dhe poetëve shqiptarë të rinj dhe të kualifikuar në këtë fushë.



## 4. Politikat e monitorimit, administrimit dhe kontrollit të rrezikut të shoqërisë

*Kevin W. Knight, ' Menaxhimi i riskut është një udhëtim ... Jo një destinacion' \*.*

### Kuadri global i menaxhimit të riskut

Menaxhimi i riskut është një proces që lejon të identifikoni, matni, monitoroni, menaxhoni dhe raportoni mbi risqet që dalin si nga jashtë ashtu edhe nga brënda shoqërisë. Qëllimi është që të garantojnë Aftësinë paguese, vazhdimësinë e biznesit dhe zhvillimin e shoqërisë nën kushte të kënaqshme të riskut dhe përfitimit.

Kuadri i menaxhimit të riskut është i organizuar rreth Menaxherit të Riskut dhe ndarjes në lidhje me riskun. Duke iu referuar linjës së dytë të mbrojtjes vazhdimisht kryen një kontroll mbi kredinë, tregun, marrjen në sigurim dhe funksionimin. Si pjesë e këtij roli, duhet të përcaktojë qëndrueshmërinë e biznesit dhe zhvillimet si dhe përputhja e tyre e përgjithshme me objektivin e profilit të riskut të vendosur.

Dërgimi i RISK-ut përfshin formulimin e rekomandimeve për politikat e riskut të shoqërisë (në lidhje me marrjen në sigurim dhe risigurimin, menaxhimin e aktiveve dhe detyrimeve, investimet, likuiditetin, administrimin e riqeve operationale dhe risigurimin), në analizimin e portofolit të rreziqeve me një perspektivë të ardhshme, në garantimin e cilësisë dhe efikasitetit të procedurave të monitorimit, dhe në përcaktimin ose vërtetimin e metodave të matjes së riskut. Është e rëndësishme gjithashtu përgjegjësia për të siguruar që të gjitha implikimet e riskut të bizneseve ose produkteve të reja janë vlerësuar në mënyrë adekuate.

## 4.1 Menaxhimi i riskut, strategjia dhe politikat e menaxhimit të riskut

Sistemi i menaxhimit të riskut:

- Përbën strategji, procese dhe procedura raportimi të nevojshme për të identifikuar, matur, menaxhuar dhe raportuar në mënyrë të vazhdueshme risqet, në një individ dhe në një nivel të agreguar, të cilat janë ose mund të jenë të ekspozuar, si dhe ndërvarësitë e tyre;
- Të integrohet në strukturën organizative dhe në proceset e vendimit
- Mbulon risqet që duhet të përfshihen në llogaritjen e RKS, si dhe risqet që nuk janë të përfshira plotësisht në llogaritjen SCR

Ky raport përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në shoqërinë Albsig sh.a., metodën sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e shoqërisë Albsig me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Shoqëria Albsig sh.a. në muajin Dhjetor 2019 në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës miratoi projektplanet për vitin 2020. Këto plane ndihmojnë në ecurinë e shoqërisë dhe në ndërtimet e standarteve për shoqërinë Albsig sh.a.

Në planin e Biznesit për vitin 2020 u përcaktua dhe ambicja e shoqërisë Albsig sh.a., për arritjet e pritshme për tu realizuar për vitin 2020.

Referuar këtij plani u përpilua dhe plani i menaxhimit të riskut për vitin 2020.







Ky plan përfshin objektivat përkatëse, parimet kryesore dhe shpërndarjen e duhur të përgjegjësive për të trajtuar riskun në të gjithë veprimtarinë dhe njësitë organizative të shoqërisë së sigurimit, përfshirë edhe degët e saj.

U përcaktua niveli i pranueshëm i riskut, i përcaktuar qartë dhe i miratuar nga Këshilli i Administrimit/ Mbikëqyrjes, duke u këshilluar me drejtuesit e lartë ekzekutivë;

Strategjia e riskut përkufizohet si qasja e njësisë për menaxhimin e riskut e përcaktuar nga drejtori i njësisë dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet njësia ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

U përcaktuan objektivat që duhet të zbatohen dhe ndiqen nga gjithë njësitë përbërëse të shoqërisë Albsig sh. a. Këto objektiva të vendosura në planin ekonomik financiar si më poshtë:

- **Synimi për të qenë shoqëri lider në treg për cilësinë e shërbimit ndaj klientëve;**
- **Shërbime cilësore dhe në kohë për klientët individë dhe bizneset nëpërmjet ofrimit të produkteve cilësore të sigurimit ekzistuese dhe të reja dhe pagesa shumë e shpejtë e dëmeve;**
- **Ruajtja e standarteve të larta në përzgjedhjen e personelit që merret me marrjen në sigurim, shitjen dhe e ndërmjetësave në sigurime;**
- **Shtimi i gamës së produkteve të reja sipas kushteve të tregut dhe kërkesave të klientëve;**
- **Mbajtja e një minimumi të raportit të aftësisë paguese ndaj nivelit minimal të kërkuar prej 250% për të krijuar aftësi absorbuese ndaj luhatjes së rezultateve;**
- **Synimi për mbajtjen e ROE minimum 10% ndaj kapitalit të vlerësuar sipas SNRF.**
- **Forcimi i kuadrit të administrimit të rreziqeve;**
- **Rritja e volumit të primeve të shkruara bruto me 18%,**
- **Përmirësimi i raportit të produkteve vullnetare;**
- **Pagesa e shpejtë e dëmeve;**
- **Arritja e një pozicioni të qëndrueshëm në tregun e sigurimeve.**
- **Përmirësimi i imazhit dhe standarteve**

## **4.2. Përbushja e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut**

Realizohet nëpërmjet:

Ngritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve të shoqërisë Albsig sh.a. lidhur me çështjet e menaxhimit të riskut.

Përballja me situatat e katastrofave, tërmetit pranimin e këtij risku dhe orientimi në të tilla situata sipas planit të miratuar në raste katastrofash të tilla si tërmeti për vazhdimësinë e biznesit dhe menaxhimin sa më mirë të situatës.



Përkufizimit të fushave të riskut dhe të detyrave delikate në veprimtarinë e shoqërisë Albsig sh.a.,  
Monitorimit të qëndrueshëm të fushave të riskut.

Ndërmarrjes së masave për eliminimin apo pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm.

Menaxhimi i Riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qënë në ekuilibër me njëri tjetrin. Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shume se një risku të vetëm duke bërë te vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm.

Modeli si një i tërë funksionon në një ambient në të cilin është përcaktuar dëshira për risk /oreksi. Koncepti i dëshirës/oreksit për risk (sa është risku i tolerueshëm apo i justifikuar) mund të konsiderohet si “një mbulesë” gjatë gjithë këtij modeli.

Një fazë e veçantë për një risk të veçantë në proces nuk do të jetë domosdoshmërisht e njëjtë për të gjitha risqet.

Thelbi i procesit të menaxhimit të riskut nuk është i izoluar, por ndodh në një kontekst dhe duhet të jepet disa inpute kyç në procesin e përgjithshëm me qëllim që të gjenerohen rezultatet e pritshme nga menaxhimi i riskut.

Standardi përcakton tiparet e një sistemi efektiv të menaxhimit të rrezikut në nivel të lartë. Kërkesat e mëtejshme dhe udhëzime në lidhje me këto janë të mbuluara në seksione të tjera të standardeve dhe udhëzimeve të përcaktuara më poshtë:

Subjekti	Referenca ne standarte /udhëzime
Strategjia e riskut	SR
Struktura qeverisëse e riskut	SQ
Proceset e marrjes së vendimeve	PV
Vetëvlerësimi i identifikimit të riskut	VIR
Raportimi i riskut	RR
Plani i vijshmërisë së veprimit	PVV

Tabela 1. Kërkesat dhe udhëzimet lidhur me riskun

### 4.3 Risqet per vitin 2019

#### Risku i Kreditit

Risku i kreditit i referohet riskut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kur pranohen primet fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguruarve.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut nga fondet e mbajtura, depozitat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedurë të brendshme nga ku risiguruesit mund të kenë klasifikime BB ose norma më të larta dhe risku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave



31 Dhjetor 2019 në '000 Lekë	A+	A	A-	AA	AA-	BB	Pa normë	Totali
Aktivitet Financiare								
Investimet							1,194,481	1,194,481
Aktive të lidhura me risigurimin	16,041	4,415	1,795	3,272	2,891	-	-	28,414
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	-	-	130,297	130,297
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	76,153	76,153
Mjete monetare në arkë dhe bankë	-	-	-	-	-	-	64,512	64,512
31 Dhjetor 2018 në '000 Lekë	A+	A	A-	AA	AA-	BB	Pa normë	Totali
Aktivitet Financiare								
Investimet							1,319,858	1,319,858
Aktive të lidhura me risigurimin	14,064	12,370	3,116	2,673	4,683	-	-	36,906
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	-	-	211,845	211,845
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	60,121	60,121
Mjete monetare në arkë dhe bankë	-	-	-	-	-	-	42,973	42,973

Tabele 2: Ekspozimi ndaj riskut të kredise



Informacione shpjeguese shtesë për primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit janë si më poshtë:

	2019				2018			
	Primet e ceduara		Aktivete risigimit		Primet e ceduara		Aktivete risigimit	
	'ooo Lek	% ndaj totalit	'oooLek	% ndaj totalit	'ooo Lek	% ndaj totalit	'ooo Lek	% ndaj totalit
<b>Norma</b>								
<b>AA</b>	7,411	4.71%	3,272	11.52%	6,574	4.77%	2,673	7.24%
<b>A+</b>	38,855	24.69%	16,041	56.45%	55,527	40.32%	14,064	38.11%
<b>A</b>	58,297	37.04%	4,415	15.54%	27,332	19.85%	12,370	33.52%
<b>A-</b>	16,018	10.18%	1,795	6.32%	12,218	8.87%	3,116	8.44%
<b>AA-</b>	36,803	23.38%	2,891	10.17%	36,050	26.18%	4,683	12.69%
<b>BB</b>	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Pa normë</b>	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	157,384	100.00%	28,414	100.00%	137,701	100.00%	36,906	100.00%

Tabele 3: Informacione shpjeguese shtesë për primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit

### Risku i Tregut

Risku i tregut për shoqërinë lidhet kryesisht me faktorë të tregut financiar, si normat e interesit dhe kurset e këmbimit, apo faktorë të jashtëm, si ecuria ekonomike, si dhe humbje nga portofoli i investimeve.

### Risku i normës së interesit

Risku i normave të interesit është i ndikuar nga risku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe risku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli risku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe risku i shkakimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

### Risku i këmbimit të monedhës së huaj

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEKË, USD dhe EURO). Flukset monetare nga të ardhurat nga primet janë burimi kryesor i fondeve për depozitat me afat në valutë të huaj. Risku i këmbimit të monedhës së huaj lind nga lëvizjet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj. Ekspozimi ndaj këtij risku kryesisht lind gjatë një periudhe në të cilën shoqëria ka një pozicion të hapur si në bilanc dhe jashtë bilancit dhe/ose me kursin aktual ose të ardhshëm të tregut.



	Ndikimi	2019 në Lek	2018 në Lek
EUR rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	131,247,349	34,794,069
EUR ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(131,247,349)	(34,794,069)
USD rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	13,301,116	13,449,848
USD ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(13,301,116)	(13,449,848)

Tabela 4: Një analizë sasiore të riskut valutor të shoqërisë më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018.

### Risku Operacional

Risku operacional lind nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij risku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollet e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmëria dhe katastrofat natyrore.

Përdorimi më efikasitet i sistemit të shitjes, administrimit dhe dëmeve ka minimizuar shumë risqe duke bërë të mundur një harmonim më të mirë midis kontrollit dhe raportimit.

Rëndësi shumë e madhe i është dhënë pagesës së dëmeve, duke e konsideruar një marketing për shoqërinë. Pagesa e dëmit në një periudhë shumë të shkurtër është një praktikë, e cila ndiqet deri në lajmërimin e klientit që vlera e dëmit të rënë dakord nga klienti ka kaluar në llogarinë e tyre dhe ka ndikuar në performancën e shoqërisë.

Analizat aktuariale ndikojnë në aplikimin e metodave më të mira aktuariale për llogaritjen e provigjoneve të dëmeve (IBNR) dhe për kontrolle më të forta mbi të dhënat nga Aktuari, sidomos të dëmeve shëndetësore të TPL, të cilat kanë luhatje në vlerësime. Për këtë Departamenti i Dëmeve bashkëpunon me Departamentin Juridik dhe Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe IT për marrjen e informacionit të plotë dhe në kohë për të gjitha rastet e ndodhura të dëmeve për tu raportuar saktë për efekt të provigjoneve teknike të dëmeve si dhe azhurnimi i dëmeve në proces gjyqësor me vendimet e gjykatave në periudhat që raportohen dhe në zbatim të “Procedura për trajtimin e dëmeve sipas statuseve të tyre dhe rakordimi ndërmjet departamenteve përkatëse”. Testimi i provigjonimit të dëmeve është bërë nëpërmjet analizës RUN-OFF të dëmeve. Kjo analizë është bërë për dëmet e ndodhura dhe të raportuara (RBNS) në shoqëri dhe për dëmet e ndodhura dhe nuk janë të raportuara (IBNR). Teste për vlerësimin e provigjoneve të dëmeve në 31.12.2018 për sigurimin e detyrueshëm motorik TPL, Karton jeshil, Kufitare dhe Kasko janë bërë në mënyrë të vazhdueshme në periudhat në vazhdim duke marrë rezultate pozitive. Megjithatë rezultatet pozitive janë marrë për IBNR, që për rrjedhojë sjell rezultatet pozitiv të totalit. Si më poshtë po japim një rezultat për MTPL, Kartonin jeshil dhe Kaskon që zënë dhe peshën kryesore në provigjonet e dëmeve total.

### Risku i Likuiditetit

Norma e likuiditetit është raporti midis aktiveve likuide të shoqërisë dhe detyrimeve të maturuara për pagesë si dhe detyrimeve që maturohen së shpejti.

Shoqëria e sigurimit konsiderohet likuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 6 të rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, është më i lartë ose i barabartë me 1 (një).



Për qëllim të monitorimit të likuiditetit shoqëria bën monitorimin e fluksit të parasë në mënyrë periodike duke u bazuar në llogaritjet me bazë ditore të normës së likuiditetit.

Gjatë vitit 2019 Shoqëria Albsig Sh.a referuar në nenin 6 të rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, ka rezultuar me vlerë të normës së likuiditetit gjithmonë më të lartë se 1 (një).

### Risku Ligjor dhe Rregullator

Risku ligjor dhe rregullator lidhet kryesisht me ndryshimin ligjor dhe rregullator.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut rregullator si krijimi i provigjoneve të primit të pafituar për sigurimin e detyrueshëm motorik sipas primeve të rrezikut të përcaktuar nga AMF, pavarësisht cmimeve të zbatuara nga shoqëria.

Gjithashtu shoqëria duhet të ketë likuiditet për krijimin e rezervës monetare.

Risku Strategjik

Risku strategjik lidhet kryesisht me pozicionimin strategjik të shoqërisë në treg. Risqe strategjike për shoqërinë janë humbje e klientëve potencialë.

## 4.4 Kuadri i Administrimit të Riskut

Shoqëria Albsig Sh.a. mbikëqyret dhe kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës. Kompetencat e këtyre organeve drejtuese përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Albsig sh.a, ka vendosur objektiva të qarta për periudhën 1-vjecare dhe rritja e sigurisë për arritjen e tyre kërkon menaxhimin e realizimit të objektivave. Kjo kërkon vendosjen dhe zotërimin e një metode të koordinuar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të riëkut, identifikimit, analizimit dhe reagimit ndaj riëqeve me të cilat përballet shoqëria. Këtu merr kuptim Politika e Menaxhimit të Riskut e cila kërkon që të shqyrtohet jo vetëm natyra e risqeve, por dhe kuptimi i koncepteve kryesore të menaxhimit të riskut.

Çdo njësi e qeverisjes duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht (të pakten një herë në 1vit) si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme.

Për të menaxhuar riskun, duhet bërë menaxhimi i proceseve eventualisht në strukturat përkatëse. Risku është pasiguria e rezultatit dhe një menaxhim i mirë i riskut lejon:

- Të rritet besimin në arritjen e rezultateve të dëshiruara
- Të trajtohen kërcënimet në mënyrë efektive në nivele të pranueshme;
- Të merren vendime të informuara mbi shfrytëzimin e mundësive.

Menaxhimi i mirë i riskut u lejon grupeve të interesit të rrisin besimin në qeverisjen e shoqërisë dhe aftësinë ofruese të saj.<sup>3</sup>

*Një strukturë e tillë është zakonisht referuar si modeli i "tre linja e mbrojtjes"*

*Një strukturë efektive në mënyrë tipike do të ketë llogaridhënie të qartë dhe pritjet që do të ndihmojë për të arritur objektivat e biznesit për të siguruar vendime që janë të koordinuara në përputhje me deklaratimet e oreksit të riskut dhe politikat. Shqyrtim i kujdesshëm duhet t'i jepet shpërndarjes dhe komunikimit të roleve, përgjegjësisë kundrejt biznesit, si dhe vendosjen e rregullave dhe proceseve të riskut bazuar në vendimmarrje dhe raportime për të siguruar që të jenë të përshtatshme.*

Është e rëndësishme që të gjitha palët e lidhura të kuptojnë rolet e tyre, përgjegjësitë dhe llogaridhënien; duke përfshirë edhe atë që pritet prej tyre dhe autoritetit për vendimmarrje në raportimin (dmth çdo individ përkatës është në gjendje të shpjegojë se cilët janë përgjegjësitë për të, në çfarë mënyrë dhe si lidhen.

*Një strukturë organizative mbështetet në administrimin efektiv të riskut. Struktura duhet të jetë e përshtatshme, zakonisht duhet të ofrojë tri nivelet e qeverisjes në lidhje me riskun:*

*Përgjegjësi direkte për menaxhimin dhe kontrollin e riskut (p.sh. stafit dhe menaxhimit të punës në njësitë në përballje me klientët /konsumatorët)*

*Koordinimi, lehtësimi dhe mbikëqyrja e efektivitetit dhe integritetit të strukturës së administrimit të riskut (p.sh. komiteti i riskut dhe funksioni i menaxhimit të riskut); Dhe*

Sigurimit të pavarur dhe sfidë në të gjitha funksionet e biznesit në lidhje me integritetin dhe efektivitetin e strukturës së administrimit të riskut (p.sh. auditimit të brendshëm dhe të jashtëm).

Duhet të sigurohet që ofrohen mjetet e duhura të menaxhimit të riskut, të cilat janë lehtësisht të arritshme, për të mbështetur proceset dhe stafin e tyre. Trajnimi i duhur dhe zhvillimi duhet të sigurohen, për të gjithë stafin, përreth të gjitha aspekteve të qasjes për menaxhimin e riskut.

Struktura organizative duhet të lehtësojë qarkullimin e informacionit korrekt të riskut rreth biznesit në kohën e duhur, dhe duhet të ketë procese në vend që merren me çështjet e riskut. Për të qenë efektiv, proceset e shkallëzimit zakonisht të jenë të arritshme për të gjithë dhe kanë të qarta, të përcaktuara, procedurat, pikat e alarmit dhe pikat e përshkallëzimit. Është e rëndësishme për të siguruar që konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e informacionit është ruajtur, veçanërisht në lidhje me këto procese të rëndësishme për suksesin e biznesit.

## 4.5 Kuadri i raportimit

Identifikimi dhe vlerësimi i riskut dhe kontrollit, duhet të marrë masat e duhura sipas nevojës. Ka një numër të mënyrave të cilat mund të përgjigjen ndaj rikut, duke përfshirë:

- Transferimi i një pjesë të rrezikut; për shembull, duke blerë sigurim ose risigurim;
- Trajtimin ose zbutje të riskut; dmth të zvogëlojë gjasat dhe/ose ndikimit të tij;
- Të pranohet ose të tolerohet nivelin aktual të riskut, ku risku i afrohet apo është në kufijtë e tolerancës së riskut. Kjo mund të jetë e përshtatshme ku zbutja e nivelit aktual të riskut është në disproporcion me përfitimet.
- Eliminimin ose përfundimin;
- Nivelet e oreksit të riskut në ndryshimin apo tolerimin e shkeljes për një kohë të shkurtër (në këtë rast arsyetimi duhet të dokumentohet). Kur përcaktimi i përshtatshmërisë së përgjigjeve të riskut konsiderohet si në vijim:
- Fizibiliteti dhe kostot relative (direkte, indirekte dhe mundësitë) dhe përfitimet e opsioneve alternative të reagimit të riskut, kostoja për të hartuar dhe zbatuar një kontroll të ri dhe kostoja në vazhdimësi e kontrollit;
- Aspektet cilësore të riskut, të tilla si ndikimi mbi riskun e reputacionit;
- Nevojën për të siguruar që përgjigjet janë bazuar në një kuptim të plotë të riskut dhe komponentëve të tij, veçanërisht shkaqet e riskut, për të siguruar ato që janë të adresuara;
- Nëse risqet nuk mund të kontrollohen për nivele të pranueshme duhet të shmangen, ose plane të vazhdimësisë së zhvillimit të krijohen.



Në programin e administrimit të riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria. Shoqëria fokusohet tek risqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjike.

Këto risqe janë pjesë e procesit të administrimit të riskut për periudhën. Pjesë e procesit të administrimit të riskut janë dhe risqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme.

Risqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuara më poshtë

#### 4.6. Kontrollat e brendshme

Aktivitetet e kontrollit veprojnë në të gjitha nivelet brenda shoqërisë për të zbutur risqet në nivele të pranueshme. Kontrollat mund të përfshijnë politikat, procedurat, sistemet dhe proceset për të gjithë shoqërinë. Kontrollat efektive janë zakonisht:

- Të përshtatshme dhe në proporcion me risqet kryesore me të cilat përballen në të gjitha nivelet, në mënyrë që të sigurojnë kosto në zbutjen e riskut të efektshme;
- Një pjesë normale e veprimtarisë së përditshme, sistemet dhe procedurat e menaxhimit dhe proceset vendimmarrëse të të gjithë biznesit;
- Koordinuar të gjithë shoqërinë;
- Nënshtrohen vlerësimit të rregullt (p.sh. janë kontrollat efektive në zbutjen e risqeve kryesore),
- Nënshtrohet një procesi të sigurimit të përgjithshëm, i cili gjithashtu adreson mjedisin më të gjerë të kontrollit.
- Mjedisi i kontrollit përfshin qasjen e qeverisjes, stilin e menaxhimit, strukturën organizative dhe kulturën e gjerë brenda të cilit kontrollojnë aktivitete që zhvillohen. Kontrollat shpesh janë kategorizuar në dy lloje:
- Pak përfshirëse - Kontrollat që zvogëlojnë gjasat e një ngjarje të riskut që ndodh. Planifikimi dhe strategjia e vendosjes, autorizimi dhe të dhënat hyrese të kontrollit
- Zbuluar - kontrollat që identifikojnë dukuritë e ngjarjeve të riskut, pasi ato kanë ndodhur dhe për të mundësuar veprime korigjuese që duhen ndërmarrë për të kufizuar shkallën e dëmtimit, p.sh. Alarme përjashtime dhe raportimi, si dhe shqyrtimet e rezultateve aktuale kundrejt pritjeve.
- Vlerësimi i riskut do të duhet të marrë në konsideratë efektivitetin me të cilën kontrollon riskun e zbutur. Një metodë është të marrin në konsideratë hartimin e një kontrolli dhe performancën e saj:
- Dizajni - konsideron si edhe kontrolli duhet të punojë në qoftë se është zbatuar gjithmonë në mënyrën se si ajo është menduar për të punuar; dhe
- Performanca - konsideron mënyrën në të cilën kontrolli është operuar në praktikë; në qoftë se është aplikuar kur duhet të jetë dhe në mënyrën e synuar nga projektuesi i saj.

#### 4.7 Toleranca dhe kufijtë e rrezikut

Toleranca ndaj rrezikut përcaktohet nga objektivat strategjike të shoqërisë. Objektivat strategjike të shoqërisë janë të lidhura kryesisht me objektivat e rritjes në treg, marzhet e synuara të fitimit dhe mbajtjen e një niveli kapitali mbi një marzh të caktuar. Në këto objektiva është përcaktuar si qëllimi i pozicionimit në treg në pjesmarrje, ashtu dhe në raport me cilësinë e shërbimit.

Matësit e nivelit të riskut që përdoren kryesisht janë kufijtë gjatë procesit të marrjes në sigurim, si për ekspozimet individuale ashtu dhe për ekspozimet agregate sipas linjave të sigurimit.





Shoqëria ka manual dhe procedura të hartuara për këtë qëllim. Shoqëria është në proces ndërtimi të një manuali të ri i cili do të jetë një ndihmesë e madhe në të ardhmen.

Shoqëria zbaton marrëveshje risigurimi treaty, fakultative në mbrojtje të kapitalit.

Një nga rreziqet më të rëndësishme të matshme nga ana sasiore, ndaj të cilit mund të përdoren strategjitë e zbutjes është vlerësuar risku i katastrofave.

Shoqësria Albsig sh.a., është në proces të rishikimit dhe ndërtimit të politikave të ndryshme të cilat janë cituar dhe në planin e menaxhimit të riskut të miratuar në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë.

Primet nga biznesi i Pronës vijnë në mënyrë vullnetare dhe nga kanalet bankare. Zbutja e këtij risku kryhet nëpërmjet risigurimit, si mekanizmi kryesor i transferimit të këtij rreziku, pasi rreziqet bazë për produktin Zjarri dhe rreziqe shtesë me përfitues bankat e nivelit të dytë ka Zjarr dhe Tërmet.

#### *Kufijtë për risigurim*

Shoqëria Albsig Sh.a ka politika të risigurimit që kanë për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe metodikën mbi bazën e të cilave lidhen programet e marrëveshjeve të risigurimit në mënyrë që aktiviteti sigures i shoqërisë të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të biznesit nga risqe të ndryshme, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Shoqëria Albsig Sh.a risiguron të gjitha risqet apo pjesë të përgjegjësive që ka kontraktuar me të siguarit që tejkalojnë mbulimin maksimal të shoqërisë, të masës 10% të Aftësisë Paguese të shoqërisë Albsig Sh.a.

Marrëveshjet e risigurimit janë nënshkruar vetëm me shoqëritë e risigurimit që përmbushin kushtet sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

### **4.8 Administrimi i kapitalit dhe Nivelit i Aftësisë Paguese**

Shoqëria ka objektiv kryesor që niveli i kapitalit që do mbajë do të jetë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Shoqëria do ruajë një nivel marzhi 250% ndaj kufirit minimal të kërkuar të kapitalit, sipas metodës me bazë primet ose dëmet, si dhe do synojë gradualisht dhe mbajtjen e një niveli të paktën 150% të fondit të garancisë.

Kjo strategji do të jetë ruajtja e kërkesave rregullatore në cdo kohë, përdorimi eficient i kapitalit, nëpërmjet analizës së vazhdueshme të treguesve të performancës. Duke patur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi për nivelin e kapitalit është testuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet skenarëve të stresit, për të bërë të mundur zbutjen e risqeve që dobësojnë fuqinë e kapitalit. Shoqëria ka testuar, duke bërë provën e rezistencës mbi bazën e shumës së sigurura, pasi nuk ka të dhëna publike në lidhje me probabilitetet dhe



dëmet e ndodhura nga katastrofat natyrore në vendin tonë. Në fund të vitit 2019 vlera e fondit të garancisë është brenda të gjitha normave të kërkuara.

#### 4.9 Aktive në mbulim të provigjoneve teknike

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe rregullores nr. 19 “Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve” aktivet në mbulim të provigjoneve teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Aktivet që mbulojnë provigjonet teknike për periudhën e fund vitit 31 Dhjetor 2019:

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt	% faktike	Investime mbi limitet e lejuara
I.	Aktivët e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		1,639,553,283		-
I.1	a) Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë	100%		0.0%	-
I.2	b) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	100%		0.0%	-
I.3	c) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emetuar nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;	10%		0.0%	-
I.4	ç) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të shoqëruara nga garanci të emetuara nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;	10%		0.0%	-
I.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%	8,000,000	0.3%	-
I.6	dh) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të cilët nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%		0.0%	-
I.7	e) Aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	25%		0.0%	-
I.8	ë) Aksione, të cilat nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%		0.0%	-
I.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%		0.0%	-
I.10	g) Hua të pasiguruara dhe hua të siguruara nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë ;	10%	43,452,162	1.6%	-

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt	% faktike	Investime mbi limitet e lejuara
I.11	g) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gj) e Ligjit 52/14:	30%	792,402,167	29.1%	-
	<i>Qëllime shfrytëzimi</i>		792,402,167		-
	<i>Qëllime investimi</i>		-		-
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	795,698,954	29.3%	-
II.	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit:		-		-
II.1	a) Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar ose vend anëtar i OECD-së; që janë të klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor's ose vlerësimi ekuivalent nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;				
II.2	b) Obligacione afatgjata dhe tituj afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar ose vendi anëtar të OECD-së; me kushtin që entitetet jo qeveritare emetuese të jenë Banka Ndërkombëtare e Pagesave (BIS), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Komisioni Evropian apo banka zhvillimi shumëpalëshe, nëse ato plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:	15%		0.0%	-
	i) Për këta tituj ekzistojnë tregje aktive të marrëveshjeve të riblerjes;				
	ii) Titujt nuk janë emetuar nga bankat apo institucione të tjera financiare.				
II.3	Aksione të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së;	15%		0.0%	-
II.4	Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat tregtohen në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së.				
III.	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, neni 4:		1,737,659,169		191,456,006
III.1	b) Kredi individuale hipotekore për apartamente banimi vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit;	1%		0.0%	-
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	64,512,427	2.4%	-

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt	% faktike	Investime mbi limitet e lejuara
III.3	ç) Të arkëtueshmet nga risiguruesit, që nuk janë pezull më shumë se 90 ditë nga lindja e detyrimit;	25%		0.0%	-
III.4	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më poshtë nga Standart & Poor;				
III.5	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%	994,798,889	36.6%	-
III.6	e) Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;	20%		0.0%	-
III.7	f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjontit të primit të pafitur;	20%	118,140,634	10.2%	-
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	159,192,963	5.9%	23,222,442
III.9	h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	20,782,066	0.8%	-
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartanit jeshil pranë BSHS	100%	38,929,869	1.4%	-
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	341,302,321	29.6%	168,233,563
IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		3,377,212,452		191,456,006
V	TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		3,185,756,446	-	
VI	C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		2,719,410,411		
VI.1	Provigjone të primit të pafitur		1,153,791,717		
VI.2	Provigjone të dëmeve		1,565,618,694		
VI.3	Provigjone për bonuse dhe rabate				
VI.4	Provigjone barazimi dhe katastrofe				
VI.5	Provigjone të tjera teknike				
VII	Tepricë (+) / Mungesë(-) (V-VI)		466,346,035		
VIII	Mbulimi në % (V/VI)		117.15%		

Tabela 5: Aktive në mbulim të provigjoneve teknike

#### 4.10 Marzhi i aftësisë paguese

Sipas vendimit nr. 191 datë 25.03.2005 “Për miratimin e metodikës: Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbejnë atë” koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhurave është vlera maximale e pritshme e diferencës midis rrezikut aktual dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

$b_1$  = koeficienti i pasigurisë, duke marrë në konsideratë shumën “a” është 0.18

$b_2$  = koeficienti i pasigurisë, i llogaritur duke marrë në konsideratë “a2” është 0.16

Sipas nenit 80 të ligjit 52 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” niveli i kërkuar i Aftësisë Paguese të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370,000,000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë paguese. Niveli aktual i aftësisë paguese më 31 Dhjetor 2019 është brenda limiteve të kërkuara.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj është si më poshtë:

	Kufiri minimal i Aftësisë paguese, Jo Jete	ALBSIG	31.12.2019
1	1.Llogaritja me baze primet		
2	Prime te shkruara mga aktiviteti i sigurimeve	2,367,406,336	leke
3	Prime te shkruara mga aktiviteti i risigurimeve	-	leke
4	Taksa te zbritshme	90,134,508	leke
5	Shuma "a" (5=2+3-4)	2,277,271,828	leke
6	Pjesa e shumës "a" me e vogël se 1,000,000,000 leke (6=min(1,000,000,000,5))	1,000,000,000	leke
7	Pjesa e shumës "a" me e madhe se 1,000,000,000 leke (7=5-6)	1,277,271,828	leke
8	Koeficienti i pasigurisë a1 (8=0.18)	0.18	
9	Koeficienti i pasigurisë a2 (9=0.16)	0.16	
